



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr 7771 Prot

Tiranë më 22/12 /2021

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit njofton si më poshtë.

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se në datën 21 .01.2022 ora 13:00 në sallën e provave të korit kati i IV brenda Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor do të zhvillohet audicioni për evidentimin dhe afrimin e zërave të rinj pranë TKOBAP. Audicioni do të zhvillohet për zërat soprano, mezzosoprano, kontralto, tenor, bariton dhe bass si zëra shtesë në Sektorin e Korit për projektet artistike në vazhdim të TKOBAP-së.

Të gjithë ata artistë të jashtëm të interesuar për pjesmarrje në projekte artistike duhet të do duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit të TKOBAP-së **deri në datën 14.01.2022 ora 14:00** dokumentat origjinale ose fotokopje për regjistrim si më poshtë vijon;

Kriteret e përgjithshme (dokumentacioni)

1. Të ketë kryer studimet e larta në degën e kantos (bachelor ose master) brenda ose jashtë vendit;
2. Diplomë e përfundimit të shkollës dhe listë notash;
3. Vërtetim që vazhdon studimet e larta në degën kanto;
4. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm.
5. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria artistike e kandidatit, master class, work shop, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, etj).

Programi :

1. Shtrirja vokale;
2. Tre arie të epokave të ndryshme nga repertori operistik, të përzgjedhura nga vetë kandidati, përkatësisht nga kompozitorët: W. A. Mozart, G. Rossini, V. Bellini, G. Verdi, G. Puccini;
3. Lexim me shikim të parë- (A prima vista).

*Pjesmarrësit që do të vlerësohen me pikët maksimale, do të angazhohen sipas nevojave të institucionit në këto projekte artistike

Konceptoi kriteret e përgjithshme: Migena Biba Juriste

Aprovoi: Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Aida Gegaj

Konceptoi artistikisht: Dirigjent Kori Dritan Lumshi

MIRATOI
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
ZANA ÇELA

